

---

# **Analizë e Raportit Vjetor të Agjencisë së Hekurudhave të Kosovës (AHR) për vitin 2019**

---

*Analizë Politikash*

---

14/2020



# Analizë e Raportit Vjetor të Agjencisë së Hekurudhave të Kosovës (AHR) për vitin 2019

---

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Qershor 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

---

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	2
Përmbledhja Ekzekutive dhe Raportimi Institucional.....	2
Raportimi rreth përgjegjësive ligjore .....	4
Raporti vjetor i sigurisë.....	6
Raporti financiar .....	7
Përfundimet dhe rekomandimet .....	8

## **Hyrje**

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), si pjesë e programit për Qeverisje Demokratike, dhe projektit për rritje të llogaridhënjes ka analizuar Raportin Vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) për vitin 2019. Analiza e INDEP është e fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e kualitetit të raportimit, të gjendjes së sektorit të hekurudhave në Kosovë si dhe në hartimin e rekomandimeve për Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është organ i pavarur që rregullon dhe mbikqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe legjislacionin në fuqi të BE-së. ARH është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 04/L-076 në muajin prill 2010. Tani ky institucion vepron në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës. ARH është përgjegjëse për: licencim, siguri, interoperabilitet, rregullim të tregut dhe kompetenca tjera që i jepen në pajtim me Ligjin për Hekurudha.

## **Përmbledhja Ekzekutive dhe Raportimi Institucional**

Pjesa e përmbledhjes ekzekutive mbetet e mangët edhe në raportin e këtij viti. Edhe këtë vit vazhdon mungesa e një analize të detajuar të objektivave të ardhshme të ARH-së. Si rezultat i këtyre mungesave edhe vështirësohet kualiteti i raportimit në Kuvend. Si rezultat ARH duhet të i japë rëndësi të madhe pjesës së sqarimit të qartë të objektivave në mënyrë që raporti të dalë më kualitativ.

Përgjithësisht sa i përket përmbajtjes institucionale, sqarimet e paraqitura në këtë raport janë mirë të detajizuara. Në raport janë të sqaruara në detaje burimet njerëzore dhe detyrat e tyre në bazë të departamenteve. Ata poashtu kanë inicuar procedura për plotësim/ndryshim të strukturës së brendshme të ARH-së, me qëllim që punët dhe aktivitetet e ARH-së, të përmbushen në mënyrë me efikase dhe efektive.

Si pjesë e raportit është edhe përshkrimi i ARH. Në këtë pjesë raporti përshkruan në detaje misionin, vizionin, kompetencat e ARH, rolet e departamenteve në hollësi. Pas analizimit të kësaj

pjese, INDEP beson se ARH ka bërë një punë të kompletuar sa i përket të dhënave rreth këtyre pjesëve.

ARH në kapitullin 4.4 paraqet Bordin Mbikëqyrës. Në këtë pjesë jep informatat në lidhje me detyrat e Bordit dhe mandati i tij. Mirëpo, nuk ka paraqitur emrat e personave të cilët janë anëtarë të bordit. Këto informata ndihmojnë në rritjen e transparencës dhe monitorimin më të mirë nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Raporti paraqet edhe të dhëna rreth pagave të personelit të ARH. Ai thekson se:

“Niveli i pagave të personelit të ARH-së që nga themelimi vazhdon që të jetë mjaft i ulët në krahasim me pagat e personelit të industrisë së hekurudhave dhe rregullatorëve tjerë të pavarur. Personeli i ARH nuk gëzon asnjë kompensim shtesë përveç pagës bazë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Si rezultat, ARH rrezikon humbjen e stafit profesional aq më tepër në këtë kohë kur investimet janë drejtuar seriozisht në këtë sektor.”

Edhe pse e thekson këtë problem, ai nuk tregon në detaje rreth kësaj çështje. Mirëpo edhe pse pa detaje shtesë, raporti tregon se zbatimi i Ligjit të Pagave do ishte i mirëpritur nga ky institucion.

Në vazhdim të raportit, si problem që targetohet nga ky raport është edhe mungesa e burimeve njerëzore. Sipas raportit: “rregullatori i hekurudhave të Kosovës ka nevojë për personel shumë të kualifikuar dhe me përvojë për t’i hartuar standardet, procedurat, rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga operatorët përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe inspektimeve”. Pa sqaruar se në cilin sektor vërehet nevoja më shumë e këtyre mungesave dhe a kanë tentuar që të plotësohen këto mungesa, sidhe përse nuk janë plotësuar.

Në vazhdim, raporti thekson se gjatë vitit 2019 ka pasur edhe trajnime të zyrtarëve të ARH. Këto trajnime kanë qenë të financuara nga donatorë ndërkombëtarë, në vende të ndryshme të BE-së si dhe vende të regjionit. Përmes tabelës janë të paraqitura trajnimet dhe organizatorët e këtyre trajnimeve. Mirëpo, mungon numri i zyrtarëve të trajnuar dhe sqarimi i detajuar se sa kanë ndikuar këto trajnime në performancën e punëtorëve.

Raporti jep sqarime edhe për asetet e këtij institucioni. Në këtë pjesë raporti thekson:

“Ka qenë dhe vazhdon të jetë kërkesë e ARH-së sigurimi i zyrave të sajë brenda përbrenda një institucioni publik, me qëllim të evitimit të pagesës së qirasë. Pavarësisht disa kërkesave të ARH-së drejtuar MAP-it, akoma kjo çështje nuk është zgjidhur dhe vazhdon të jetë ngarkesë buxhetore për institucionin. Zyrat e ARH-së janë në Prishtinë në Rr. “Rrustem Statovci” nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 400 m<sup>2</sup>. Investim tjetër i nevojshëm është edhe furnizimi me pajisje të tjera, me inventar për zyre dhe mjete tjera për nevoja të ARH-së.”

Sa i përket detajeve në lidhje me pagesën e qirasë dhe se çfarë nevoja tjera ka ky institucion nuk ka detaje.

### **Raportimi rreth përgjegjësiave ligjore**

ARH paraqet një formë të detajuar të kornizës ligjore. Ajo mëtej sqaron se “ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor”. Në vazhdim të raportit është e paraqitur edhe baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në, ku vërehet se gjatë viti 2019 janë nxjerrë tri rregullore në pajtim me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

Në vazhdim ARH paraqet edhe iniciativën e tyre për përmirësimin e bazës ligjore. Këtu theksohet se nga ARH ka pasur iniciativë për fillimin e procedurave për plotësim/ndryshim përmbajtësorë të Ligjit ekzistues të hekurudhave. Por që pavarësisht nga kjo, nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret në drejtim të plotësim/ndryshimit të Ligjit për Hekurudha. Mirëpo, edhe pse e ngritë këtë çështje, në këtë pjesë është e nevojshme të sqarohet se përse nuk është ndërmarrë ndonjë hap lidhur me këtë.

Mëtej, ARH sqaron edhe vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet. Në këto vështirësi, raporti thekson se ka ende paqartësi rreth kompetencave ndërinstytucionale mes ARH dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit si dhe mos përputhshmërisë me disa nga Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e transportit hekurudhor. Poashtu, shton se këto probleme janë qysh nga koha e themelimit të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës dhe ende janë të pandryshuara. Por nuk sqarohet se në çfarë forme janë kërkuara rregullimet e këtyre çështjeve dhe a kanë pasur ndonjë përgjigje qoftë pozitive apo negative nga ana e Kuvendit.

Planifikimi dhe realizimi i punës së ARH gjatë vitit 2019 është i paraqitur në tabelë. Përmes kësaj tablele paraqiten aktivitetet e planifikuara në tri statuse: si të papërfunduara, në proces dhe të realizuara. Në aktivitetin “Regjistrimi i mjeteve lëvizëse” shkruan se nuk është pranuar asnjë aplikacion për regjistrim të mjeteve lëvizëse, duke lënë të kuptohet se gjatë këtij viti nuk ka pasur mjete të reja lëvizëse të inkuadruara në Hekurudhat e Kosovës.

Në raport shkruan edhe për inspektimet e makinistëve. Në këtë pjesë sqarohet se kanë qenë gjithsej dy inspektime gjatë vitit, ku të dyja rastet makinistët kanë qenë të licencuar dhe se ska pasur ndonjë shkelje ligjore. Mirëpo nuk jepin sqarime në lidhje me atë se sa është efektive ky numër i vizitave dhe a është i mjaftueshëm që brenda vitit të bëhen vetëm dy inspektime.

Përpos inspektimeve të makinistëve, raporti informon edhe për inspektimet e infrastrukturës hekurudhore. Në këtë pjesë sqarohet se ka pasur disa inspektime dhe se janë gjetur mangësi gjatë këtyre inspektimeve të cilat i kanë paraqitur në raporte të ndara. Këto raporte nuk janë të përfshira në raportin vjetor. Gjithashtu mungojnë të dhënat rreth numrit të inspektimeve dhe informimit rreth atyre mangësive.

Trendi i njëjtë i raportimit vazhdon edhe me inspektimin e Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore. Raportohet se ka pasur inspektime të këtyre mjeteve dhe se këto inspektime janë të paraqitura në një raport. Mirëpo ky raport nuk është i përfshirë në raportin vjetor e as nuk ka ndonjë vegëz e cila mund të na drejtojë për atë raport.

Gjithashtu, në raport është e paraqitur edhe pjesa për monitorimin e licencave. Në këtë pjesë ka sqarime edhe për raportet mjekësore periodike nga institucionet shëndetësore kompetente që kryhen gjatë këtij monitorimi. Tregohet se janë gjithsej 37 licenca të lëshuara ndër vite. Poashtu, sqarohet se te makinistët me moshën mbi 55 vjeçare këto raporte mjekësore duhet të i përsërisin çdo vit. Mirëpo mungojnë të dhënat rreth moshës së makinistëve dhe se sa prej tyre janë në moshën mbi 55 vjeçare.

Në vazhdim raporti në pikën 6.8 paraqet azhurnimin e regjistrave. Në këtë pikë raporti flet për regjistrin e Licencave në kuadër të ARH-së dhe regjistrin Qendror të Lejeve dhe Licencave. Mirëpo këto licenca nuk janë të paraqitura qoftë në formë tabelare ose në ndonjë formë tjetër në këtë raport. Ky paraqitje vetëm sa do e pasuronte më shumë këtë raport.

E njëjta frymë e raportimit vërehet edhe tek pika 6.9. Në këtë pikë paraqiten të dhëna rreth Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR). Mirëpo edhe këtu mungojnë të dhënat e kërkuara rreth regjistrave të mjeteve lëvizëse.

## Raporti vjetor i sigurisë

Sa i përket aktiviteteve për rritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore, ARH paraqet raportin vjetor të sigurisë. Ky raport përpilohet në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 neni 20 paragrafi 1 dhe Ligjit Nr. 04/L-063, neni 103, paragrafi 6. Ky raport përshkruan të gjitha informatat e sigurisë që kanë të bëjnë me sigurinë hekurudhore, ndryshimet në legjislacion, zhvillimet në certifikatën e sigurisë dhe autorizimit të sigurisë, raportet nga mbikqyrja e menaxherit të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse etj.

Sipas ligjit Nr. 04/L-063, neni 103, paragrafi 6:

“Çdo vit, të gjithë menaxheret e infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjet hekurudhore (NH) para 30 qershorit duhet të paraqesin raportin vjetor të sigurisë në lidhje me vitin kalendarik të mëparshëm te organi përgjegjës për sigurinë, gjithashtu përgatitja e raportit vjetor të sigurisë është e paraparë edhe në direktivën Nr. 2004/49/EC, nenin 9 paragrafi 4.”

Në raport janë të paraqitura datat e dorëzimit të raporteve vjetore financiare të tri kompanive aktive të licencuara. Mirëpo, përderisa në faqe 43 të raportit janë të paraqitura në formë tabelare 4 ndërmarrje aktive, atëherë duhet sqaruar mungesa e njërit raport vjetor të sigurisë.

<b>Ndërmarrja</b>	<b>VKM</b>	<b>Shteti</b>	<b>Statusi</b>	<b>Webfaqja</b>
<b>INFRAKOS</b>	IHK	KS	Në përdorim	<a href="http://www.kosovorailway.com">www.kosovorailway.com</a>
<b>TRAINKOS</b>	TRKOS	KS	Në përdorim	<a href="http://www.trainkos.com">www.trainkos.com</a>
<b>RAILTRANS</b>	RT	KS	Në përdorim	<a href="http://www.railtrans.biz">www.railtrans.biz</a>



<b>NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C</b>	NCF	KS	Në përdorim	<a href="http://www.cunicoresources.com">www.cunicoresources.com</a>
--	-----	----	-------------	--

Në faqen 54 në raport është pjesa në lidhje me Planin Strategjik 2019-2023. Në këtë pjesë thuhet se “Me qëllim të definimit të vizionit dhe misionit të ARH-së, në arritjen e objektivave strategjike dhe aktiviteteve specifike për periudhën e ardhshme pesë vjeçare dhe me qëllim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, ARH gjatë vitit 2019 është miratuar Planin Strategjik për periudhën 2019 – 2023”. Mirëpo se çfarë përmbanë ky plan dhe se cilat janë prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan, nuk ka kurrfarë sqarime.

## **Raporti financiar**

ARH përmes raportit vjetor e përfshinë pjesën e financave. Përmes kësaj pjese raporti jep detaje rreth operacioneve financiare të autoritetit gjatë vitit. Vlen të theksohet se për dallim nga raportet e kaluara, këtë vit në raportimin financiar ka pasur krahasueshmëri jo vetëm me vitin paraprak, por edhe me vitet 2018 dhe 2017. Praktikë kjo e cila nuk ka qenë e zbatueshme në raportet e viteve të kaluara.

Pasqyra financiare është e paraqitur në formë tabelare. Në pjesën e përshkrimeve janë të paraqitura kategoritë financiare. Vlen të përmendet kategoria e parë “paga dhe mëditje”. Për dallim prej raporteve vjetore të institucioneve tjera, raporti i ARH jep të dhëna tabelare të detajuara në forma të ndara për pagat dhe mëditjet. Praktikë kjo që duhet përcjellur edhe insitucionet e tjera gjatë përpilimit të raporteve vjetore.

Përpos raportit financiar, ARH përmes raportit vjetor paraqet edhe pjesën e prokurimit. Ku siç thekson raporti: “ARH, sipas obligimeve ligjore ka bërë përgatitjen e Planifikimit të Prokurimit, në të cilin janë paraparë të gjitha kërkesat për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në bazë të kërkesave të pranuar nga të gjitha njësitë e kërkesës”. Mirëpo të dhënat rreth këtij planifikimi janë të mangëta.

ARH sikur çdo vit i është nënshtruar raportit të Auditimit. Për dallim nga vitet e kaluara, këtë vit Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka ndarë opinion dhe vlerësimi pozitiv për ARH. Kjo pasiqë auditimi i kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka rezultuar me asnjë të gjetur dhe asnjë rekomandim të dhënë ndaj ARH.

## **Përfundimet dhe rekomandimet**

Në bazë të analizës së bërë nga INDEP, raporti i ARH-së tregon një përmbajtje përgjithësisht të mirë sa i përket raportit për 2019. Megjithatë, ARH duhet të fokusohet në shtimin e informatave në lidhje me disa fusha. Njëra ndër to është edhe përcaktimi i qartë i objektivave të ardhshme të ARH për vitet në vijim.

Në mënyrë që raportimi të jetë sa më transparent, ARH duhet të japë detaje rreth përbërjes së Bordit. ARH ka bërë një përshkrim mjaft të detajuar rreth mandatit të bordit dhe strukturimit të tij, mirëpo mungojnë të dhënat rreth emrave të anëtarëve të Bordit dhe përgatitjes së tyre. Andaj INDEP thekson se për informimin deputetëve dhe opinionit i gjerë do ishte më e përshtatshme.

Raporti duhet poashtu duhet të përfshijë një analizë të nevojave të saj për kërkesa për staf shtesë dhe nevojave për kompensim të stafit. Kjo pasiqë raporti thekson se kanë mungesë të stafit dhe se nuk kanë kurrfarë pagese shtesë. Përderisa theksohet si e nevojshme shtimi i numrit të punëtorëve, duhet të jepen sqarime rreth vendeve të cilat kërkohet ky shtim dhe sa është numri i nevojshëm.

Një pasqyrë e qartë duhet të jetë e pranishme edhe tek pjesa e trajnimeve. Në raport sqarohet se ka pasur trajnime të zyrtarëve të ARH edhe brenda vendit, por edhe jashtë tij. Në raport sqarohet edhe përmbajtja e trajnimeve, mirëpo mungojnë të dhënat në lidhje me numrin e zyrtarëve të trajnuar dhe sqarimet se sa kanë ndihmuar këto trajnime në performancën e ARH.

Sa i përket inspektimeve, ARH duhet të sqarojë më shumë detaje në lidhje me to. Duhet të sqarohet se a janë të mjaftueshme këto inspektime. Poashtu duhet të japë detaje në formë tabelare në lidhje me moshën e makinistëve dhe të dhëna shtesë rreth tyre dhe përbërjes së tyre.

Sa i përket raportit financiar, INDEP mendon se ka qenë mjaft mirë e detajizuar. Praktikë kjo që duhet ta ndjekin edhe institucionet e tjera gjatë përpilimit të raportit vjetor në vitet në vijim. Gjithashtu e njëjta vlenë te kategorizimi dhe ndarja e kategorive në detaje e cila i jep raportit një

frymë më të kompletuar dhe të përshtatshme për qasjen më të lehtë të deputetëve dhe opinionit të gjerë.